



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Në mbështetje të neneve 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe nenit 58 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari nxjerrë këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPJAN

SHPALLJE

Pranuar me: Priljeno:	06.02.2024	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
12-320/01-	7064	

I. Qëllimi i shpalljes për aplikim

Qëllimi i shpalljes për aplikim është përkrahja e fermerëve për vitin 2024, fermerët do të përkrahen me freza për traktor.

II. Kriteret për aplikim

- Të jenë banorë të Komunës së Lipjanit
- Toka me qenë në territorin e Komunës së Lipjanit.
- Përfituesi duhet të posedojë sipërfaqe të pronës së mbjellur mbi 1/ ha
- Nuk mund të jenë përfitues anëtarët e së njëjtës bashkësi familjare të përfituesve të 3 viteve të fundit nga Komuna dhe donatorët
- Përfituesi duhet të jetë aktiv në kultivimin e kulturave lavërtare dhe pemëtare
- Të posedoj traktor dhe të ketë dëshminë që vërteton pronësinë në emër të tij ose të njërit nga familjarët
- Përfituesi nuk duhet të jetë në mardhënie pune me institucionin që e bënë përkrahjen

III. Dokumentet e bashkangjitura

Aplikuesit duhet të dorëzojnë aplikacionin së bashku me dokumentet e bashkangjitura:

- Kopja e letërnjoftimit
- Fletëposedim për patundshmëri (të jetë në emër të aplikuesit ose të ndonjë antari të familjes dhe të jetë origjinal). Dëshmi që vërteton afërsinë familjare. (Certifikata e lindjes së aplikuesit dhe certifikata e lindjes ose e vdekjes së pronarit të tokës).
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë **(të jetë origjinal)**
- Kopja e librezës së traktorit (ose dëshmia nga noteri që tregon pronësinë e mjetit të aplikuesit ose të ndonjë antari të familjes).
- Çertifikatën e Bashkësisë Familjare *(kërkohet vetëm orgjinal)*.

IV. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim,
- Thirtja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit,
- Aplikacioni për plotësim mund të shkarkohet nga web-faqja e Komunës ose mund të merret në zyret e Drejtoratit të Bujqësisë dhe së bashku me dokumentat e bashkangjitura duhet të dorëzohet në zyret pritëse të Arhives së Komunës

V. Përzgjedhja

- Aplikimet kontrollohen, pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë verifikohet aplikacioni në terren nga komisioni,
- Komuna e Lipjanit do të lidhë Marrëveshje me përfituesit për frez për traktor, i cili obligohet që të mos e bëj tjetërsimin (shitje, dhënje në shfrytëzim etj.)
- Komisioni është i obliguar që të mbaj procesverbal për çdo aplikues.

Sqarim:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i pakompletuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

Lipjan:
06/02 /2024

Drejtori i Bujqësisë
Rexhep Rexhepi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN/MUNICIPALITY OF LIPJAN



KËRKESË PËR FREZË TË TRAKTORIT

Emri, emri i babës dhe mbiemri i aplikuesit _____

Rruga, Fshati, Nr.i shtëpisë _____ Nr tel. _____

1. Të dhënat për traktor:

Po

Jo

2. Të dhënat për sipërfaqen e tokës: _____

Arsyeja qe jeni i interesuar _____

Me aplikacion duhet të bashkëngjitni edhe dokumentet e nevojshme:

- Kopja e letërnjoftimit
- Fletëposedim për patundshmëri (të jetë në emër të aplikuesit ose të ndonjë antari të familjes dhe të jetë origjinal). Dëshmi që vërteton afërsin familjare. (Certifikata e lindjes së aplikuesit dhe certifikata e lindjes ose e vdekjes së pronarit të tokës)
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (të jetë origjinal)
- Kopja e librezës së traktorit. (ose dëshmia nga noteri që tregonë pronsinë e mjetit të aplikuesit ose të ndonjë antari të familjes).
- Çertifikatën e Bashkësisë Familjare (*kërkohet vetëm orgjinal*).

Vendi _____, Data _____, Nënshkrimi i aplikuesit _____